

FJALA

Pershendetese ne tryezen “Shprehja e lire – sfida dhe...”

Të dashur dhe të respektuar të gjithë ju që merrni pjesë në këtë debat me qëllim të dhënies së kontributit në analizimin dhe zbrërthimin e çështjeve që kanë të bëjnë në lidhje me të menduarit lirshëm si dhe me shprehjen lirshëm të mendimit personal.

Pa dyshim, shprehja lirshëm e mendimit jo vetëm që është një vlerë në tërë atë sistem vlerash që e përbëjnë demokracinë, porse, mbi të gjitha, është një vlerë që del dhe që porositet edhe nga mësimet e shenjta. Praktika islame e njeh këtë vlerë, madje, jo vetëm që e njeh, por edhe e ka kultivuar shumë. Shprehja e mendimit të lirë, që do të thotë, mendimi tjetërsoj nga ai i të parit, jo vetëm që e ka ngritur sistemin e këshillës, pandam sistemit të sotëm parlamentar, e që në islam njihet si “*shura*”, por të njëjtin sistem e ka ngritur deri në përmasa të vlerave universale për mbarë njerëzimin. Shih për këtë se çka i thotë All-llahu xh. sh. Pejgamberit a.s.: **“Në saje të mëshirës së All-llahut, u solle butësisht me ta (o Muhammed) e sikur të ishe i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje. Falju gabimin atyre dhe kërko falje te All-llahu për ta, e bisedo - këshillohu me ta për punë të jetesës. Kur të vendosish për dicka, mbështetu te All-llahu. Se All-llahu me të vërtetë i don ata që mbështeten tek Ai.”** Kur’an, Ali Imran, 159

Pa dyshim, edhe feja islame, si të gjithë fetë dhe sistemet e tjera njerëzore, shprehjen e lirë të mendimit e ka kodifikuar në tërësinë e vlerave që e shtresojnë mirëqenien si porosi të shenjtë - *sunnet* dhe si synim permanent i një shoqërie të shëndoshë. Pra, aty ku ka shkelje dhe refuzim të mendimit të lirë, aty kemi të bëjmë me njëmendësinë, me sistemin totalitar, me sistemin që e nëpërkëmb jo vetëm mendimin e njeriut por edhe vetë dinjitetin e tij si krijesë e Zotit. Por, a do të thotë kjo se, tani, meqë islami sikundër edhe fetë e tjera qiellore po e lejuakan dhe po e preferuakan mendimin e lirë, pra, a do të thotë kjo se tani në emër të kësaj vlere secili, kudo

dhe kurdo mund të shpreh lirshëm edhe mendim të tillë që shkakton sherr, që provokon dhe që inicon shkatërrim, devijim madje edhe luftë!?

Nuk jam ithar i atij mendimi që nënvizon se edhe mendimi i lirë duhet të kontrollohet. Unë them që çdo mendim i lirë duhet të jetë i ndërgjegjshëm, pra, të shprehet lirë por me ndërgjegje më të lartë. Sepse, mendim i lirë mund të jetë edhe propozimi dhe inicimi i rrënimit të një ure që lidh bregun e një fshati me bregun tjetër ku funksionon ambulanca, shkolla dhe dyqanet, institucione këto jetike për atë fshat! Pra, nëse mendimi i lirë del me një strukturë që nuk ka të bëjë fare me ndërgjegjshëmrinë, atëherë, kemi të bëjmë me një subjekt jo të shëndoshë, me një subjekt të cilit i duhet një trajtim fillimisht mjekësor pastaj edhe shoqëror, deri në risociolizimin e plotë të tij! Sepse, vetëm në këtë mënyrë mund të evitohen hapat e gabueshme, iniciativat e papërgjegjshme dhe veprimet e pandërgjegjshme që mund të rezultojnë si pasojë e mendimit që shprehet në emër të institucionit **“mendim i lirë”**!

Çka mund të bëjë një veprim i ndërmarrur në emër të shprehjes së mendimit të lirë? Se cilat mund të jenë pasojat e kësaj tashmë u panë anekënd botës, pamje kjo që shprehu një revoltë kundër botimit të karikaturave me përmbajtje që mëtonin ta fyenin Personalitetin e shenjtë të Pejgamberit tonë, Muhamedit a.s. Bota u bind, por jo për herë të parë, se loja me ndjenjat fetare mund të jetë një lojë me pasoja katastrofale për mbarë njerëzimin. Ndërsa, bota islame dhe shoqëria e përgjithshme muslimane përgjatë reagimeve të veta me këtë rast, nxori një konstatim shumë human! Pati tentativa që, me rastin e protestave gjithëmuslimane kundër këtyre karikaturave, të keqpërdoret e drejta e protestës dhe të imponohet dhunshëm liria e reagimit deri në krijim të situatave të padëshirueshme sidomos për shoqërinë muslimane. Me këtë rast ndodhën dy fenomene gati diametralisht të kundërt saqë nisën të konceptohen edhe si dy paradokse të çuditshme! Në njërën anë, aparatet shtetërore që mbronin autorin e **“mendimit të lirë”** si dhe **“lirinë e shprehjes së mendimit të lirë”**, qoftë ky mendim edhe cenues për një vlerë të shenjtë që i përket një shoqërie të gjërë,

dhe, në anën tjetër, aparatet shtetërore që duke i izuluar dhe rrethuar protestuesit e revoltuar, tentonin t'i mbronin eksterritorët diplomatike që konceptohen si vlera të shoqërisë perëndimore.

Sidoqoftë, të gjithë ne si muslimanë duhet të jemi të lumtur që në tërë situatën e krijuar me botimin e atyre karikaturave ofenduese, u arrit një poentim jo edhe aq i vogël. Kënaq fakti se, shtetet më të fuqishme perëndimore dhe establishmenti i tyre politik u prononcuan kundër atij **“mendimi të lirë”** i cili nuk dallon ofendimin nga kritika e mirëfilltë. Edhe më fuqishëm tingëlloi përkrahja dhe reagimi që arriti nga Selia e Shenjtë e që ishte identik me atë të qëndrimeve islame: edhe mendimi i lirë e ka limitin e vet, mendim i lirë nuk do të thotë përdhosje dhe shkelje të dinjitetit të tjetrit, e aq më pak të nëpërkëmbet personaliteti i të gjithë të peygamberëve të Allahut xh.sh.

Po çka do të thotë shprehje e mendimit të lirë?

Unë vlerësoj se, mendja dhe shpirti i njeriut kanë mundësi dhe horizonte të pakufizuara të cilat mund të arrihen vetëm kur ka qëllime dhe synime të pastra dhe humane. Në çastin kur preken urdhërat e Zotit atëherë më nuk ka liri mendimi, atëherë kemi anarki, jobesim dhe tendencë për shkelje të lirisë së njeriut. E unë besoj thellë, sikurse që besoni edhe ju se, përparimi dhe progresi i civilizimit gjithënjëzëz bëhet vetëm përmes kultivimit dhe respektimit të vlerave dhe idealeve të secilit, që do të thotë, edhe përmes respektimit të ndërsjellë ndaj feve dhe vlerave të përgjithshme fetare.

Në fund, i dëshiroj këtij forumi që të kontribojë sado pak në avancimin e mendimit të ndërgjegjshëm dhe të shprehjes së lirë të këtij mendimi në favor të mirëqenies së përgjithshme njerëzore.

Ju falemnderit.

H. Bahri ef. Aliu

Zv/Reisul ulema i BFI